

SHQIPTARËT NË SHTETIN PAPNOR

Giovanni ARMILLOTTA

HISTORIA E PIANIANOS, NJË FSHAT PRANË VITERBOS, NGULIMI I VETËM SHQIPTAR NË KUFIJTË POLITIKË TË SHTETIT PAPNOR

Angelo Masci në Diskutimin mbi Shqiptarët e Mbretërisë së Napolit (titulli në origjinal *Discorso sugli Albanesi del Regno di Napoli 1807*, ribotuar nga Marco, Lungro 1990, megjithëse kufizon kërkimin në atë mbretëri, prek shkarazi edhe praninë shqiptare në Mbretërinë e Sicilisë, por nuk përmend atë çka kishte ndodhur mbi gjysmë shekulli më parë në Shtetin e Kishës.

I vetmi emigracion shqiptar në kufijtë politikë të Papës nuk pati jehonën e duhur derisa studiuesi M. Puccini në revistën "La Lettura", e përmuajshme e gazetës "Corriere della Sera" (prill 1915), nuk i tregoi vendit për ekzistencën e këtij ngulimi të vogël por homogjen: Fshatra shqiptarë në Lazio.

Kaluan shumë vjet deri kur Gianni Ribeca, në një tezë diplome të vitit 1948, të gjetur në vitin 2005 falë kërkimeve të Italo Sarros, trajtoi argumentin. Kaloi sërish mëse çerek shekulli dhe çështja u shqyrtua përsëri nga Luigi Fioriti, që ringriti problemin në revistën "Zjarri": *Komuniteti shqiptar i Pianianos* (1975, Nr. 1-2) dhe *Emigracion shqiptar në Tuscia* (1989, Nr. 33). Veç tyre, u botuan nga Elettra Angelucci, *Shqiptarët në Pianiano* ("Biblioteca e Società", VII/1985 e VIII/1986) dhe më i fundit libër *Pianiano-Një ngulim shqiptar në Shtetin Papnor* nga i sipërpërmenduri Prof. Sarro (S.Ed. Editore, Viterbo, 2004).

Le të shohim nga afër zhvillimin e atyre ngjarjeve që sollën në jetë epokën jetëshkurtër të Arbërisë romane, thuajse të panjohur.

Në jug-perëndim të liqenit të Bolsenës, në territorin që shtrihet nga Montalto di Castro deri në Viterbo, ndeshen me intervale të rrallë fshatra të vegjël dhe kështjella. Ato i rrethon marema e Lazios. Kodra të vogla, me shpella natyrore dhe pyje, që i japin edhe sot e kësaj dite aspekt të egër vendeve të pabanuara.

Fshatrat e vegjël të zonës - shkruante Puccini - "që kanë ndërtesa krejtësisht shqiptare quhen Ischia di Castro dhe Pianiano". Kjo e fundit është një lagje e vogël dhe fraksion e bashkisë së Celleres, vendlindje e banditit legjendar antisavojard Domenico Tiburzi. Pianiano është kështjellë e ngritur mbi një shtresë shtufi me disa shtëpi. Ischia di Castro, edhe ky në provincën e Viterbos, është pranë Montefiascones (qytet i njohur për verën Est est est). Është fshat i këndshëm me rreth 2.500 banorë, mbi një shtresë shtufi vulkanik, 384 metra mbi nivelin e detit; i parë nga lindja duket si një anije e gjerë e bardhë. Kështjella e tij që i përkiste familjes Farnese është ndër më të bukurat dhe më të lashtat e krahinës. Le të shohim historikisht marrjen e këtyre fshatrave nga kolonia shqiptare.

Në vitin 1753 një tregtar shqiptar, Anton Remani, zbarkoi në Senigallia. Këtu, në Marche, që atëherë ishte qytet i Shtetit Papnor, zhvillohej dhe vazhdon të zhvillohet çdo vit, që nga gjysma e parë e Gjashtëqindës, i famshmi Panair i Madalenës (Fiera di Maddalena). Remani, çdo vit mbërrinte me letra rekomandimi për autoritetet papnore të Arqipeshkopit të Barit dhe të Peshkopit të Shkodrës. Atë herë solli me vete, përveç rekomandimeve, një numër të madh letrash shqiptarësh që donin të braktisnin shtëpitë e tyre për shkak të persekutimit otoman: ata i kërkonin Papa Benediktin XIV (1740-1758) ndihmë dhe mbrojtje dhe ai pranoi t'ua japë. Me t'u kthyer në Shqipëri, Remani mblodhi shqiptarët më në rrezik dhe, me të gjetur një mjet lundrues - sot do të thonim "skafistët" - tridhjetenëntë familje shkodrane, gjithsej 218 vetë, u nisën për në drejtim të brigjeve italiane. Udhëtimi i ndërmarrë në janar të vitit 1756 zgjati 33 ditë deri kur më në fund mbërritën në Ancona. I ngarkuari i Papës në kryevendin markixhan, Corrado Ferretti, urdhëroi Golfalonierin, markezin Trionfi, t'u jepte strehë dhe ushqim të ardhurve. Remanit -



Pianiano, Viterbo

”

Ngulmimi i vetëm shqiptar në kufijtë politikë të Shtetit Papnor është një qëndrim i përkohshëm në një fshat të Viterbos.

Të pakënaqur nga klima moçalore shqiptarët e vendosur në Viterbo do të largoheshin pak vjet më vonë drejt Mbretërisë së Napolit për të themeluar, bashkë me të huaj të tjerë, qytetin e sotëm të Poggio Reales.

që vinte nga një fis bajraktarësh të zonës së Velipojës pranë lumit Buna, dhe që për aktin e kryer kishte humbur të gjitha pasuritë e tij, si troje, shtëpi (mes të tjerash edhe një vilë në Shkodër) dhe mallra të tregtueshëm - Papa i caktoi 8 skude në muaj. Ndërsa vëllai i tij prift, Stefani, që ndodhej në Romë në Propaganda Fide (kongregacion që kishte për detyrë organizimin e të gjithë veprimtarisë misionare të kishës), u zgjodh drejtues shpirtëror i komunitetit i shpërblyer me 8 skude në muaj.

Pas pak kohësh këto çeçe nuk iu dhanë më, dhe Anton Remani, i katandisur në mjerim, vdiq duke lënë pas shumë fëmijë. Për mëshirë Ferretti iu drejtua Kardinalit Giovanni Francesco Banchieri, Arkëtar i Përgjithshëm i të Nderuarës Dhomë Apostolike (organi më i lartë administrativ i Shtetit të Papës), me letrën e datës 14 tetor 1757, duke iu lutur të ndihmojë në njëfarë mënyre familjen Remani dhe të tjerat (në atë kohë në Ancona); kështu, Kardinali Banchieri mori nga e Nderuara Dhomë Apostolike në përdorim të përhershëm terrene djerrë në lagjen e pabanuar të Pianianos të shtetit antik të Castros. Lagje e braktisur krejtësisht që nga viti 1734 dhe që sillte humbje të mëdha për arkat e shtetit; situatë që do të rregullohej vetëm me mbërritjen e shqiptarëve.

Studiuesi Puccini rigjeti instrumentin e këtij koncesioni, me datë 29 nëntor 1757, mes dokumenteve të Boncompagnit, noter i Capodimontes. Kopja u shpall publikisht nga noteri Salvatori më 10 qershor 1758. Instrumenti i koncesionit është me vlerë të vyer më tepër për përmbajtjen sesa për formën. Në fakt, dhurimi nuk ishte gjë e zakonshme për atë kohë: fakti që u bë në mënyrë kaq të thjeshtë është kuptimplotë. Për më tepër, refugjatëve shqiptarë iu dhanë "40 krerë bagëti, si dhe mjete pune për shpyllëzim, heqjen e rrënjëve dhe për të kthyer tokën nga djerrë në të punueshme".

Në vitin 1759 u përhap fjala që familjet shqiptare do të ktheheshin në atdhe kështu që me një instrument qiraje që ato kishin lidhur në favor të zotërinjve PietroPaolo dhe Benedetto Valdambrini, u hodh hapi i parë që, pas largimit të familjeve nga Shteti i Castros, të ishte e ligjshme për qiramarrësit marrja e terrreneve.

Më 28 nëntor 1760, për shkak të kushteve të pashëndetshme të zonës, që u kishte marrë jetën 76 vetëve, shqiptarët nuk u kthyen në Shqipëri por, me ndihmën e Papa Klementit XIII (1758-1769), emigruan drejt Capitanatës në Mbretërinë e Napolit, dhe bashkë me italianë e të huaj të tjerë themeluan qytetin Poggio Imperiale, siç dëshmojnë dokumentet e Peshkopit të asokohe të Lucerës, Imzot Giuseppe Maria Foschi. Dua të kujtoj që edhe në Chieuti, dy hapa nga Capitanata, kishte një komunitet shqiptarësh që prej shekullit XV. Poggio Imperiale lindi falë Placido Imperiales, Princ i Sant'Angelo dei Lombardi (në Avellino) dhe Signore i Gjenovës që jetonte në Oborrin e Napolit.

II.

Princi Placido Imperiale përqafoi idetë iluministe të kohës dhe nisi një eksperiment të madh kolonizimi, duke bujtur falas familje të shumta italiane dhe të huaja. Ndërkohë trojet e Pianianos u kthyen sërish në pronësi të Valdambrinëve që i dhanë me qira.

"Erdhën ndërkohë shqiptarë në Poggio Imperiale me dy priftërinj të ritit grek, Simone Bubici e Stefano Teodoro: por emigruan pas një viti ndoshta për shkak të të korrave të këqia të vitit 1762 me ngrica. Morën rrugën për në Romë, e këtu mbetën vetëm Simone Bubici me gruan dhe pesë djemtë e tij, Giuseppe Teodoro me tre djemtë e tri vajzat dhe Giovanni Bubici me të shoqen dhe të ëmën. Më pas erdhën familja Mauricchi i Shkodrës nga Barletta, dhe të tjerë nga të tjera vise. Ruajtën

vijon nga faqja 17

gjuhën dhe ritin grek, por edhe favoritet. [...] Prej tyre, i fundit që vdiq këtu më 15 shkurt 1832 qe Gregorio Mauricchi nga Shkodra, që la djalin Michele dhe tre vajza" (Matteo Fraccacreta, Teatro Topografico Storico-Poetico i Capitanatës, Tomo IV, Tip. A. Coda, Napoli 1834).

Me t'u kthyer në Pianiano shqiptarët kërkuar të rimerrnin tokat. Nisën një gjyq që zgjati shumë. Më në fund me ndërhyrjen e hirësisë Ferdinando Spinelli - i dërguar i Vatikanit dhe më pas, nga viti 1785, Kardinal i emëruar nga Papa Pio VI (1775-99) - çështja u mbyll në vitin 1770, me anë të një kontrate që rifuqizonte paktet e vitit 1757. Dhe shqiptarët ndenjën aty.

Priftit Remani iu besua shpirtërisht komuniteti që me kalimin e viteve u rrit, u shtua dhe u zgjerua në territor. Pas vdekjes së Remanit, ngelën në Pianiano një motër e tij, e martuar me një të familjes Mida, shqiptar edhe ai, dhe familje të tjera. Deri në gjysmën e shekullit XIX ruajtën ritet e lutjet e tyre dhe të njëjtat zakone që kishin në atdhe; edhe pse në vitin 1844 nuk u emërua asnjë për rolin e drejtuesit spiritual. Në famullinë e Pianianos kushtuar San Sigismondos, ku ndodhej një Shën Mari e gdhendur në trung lisi nga një shqiptar: imazh i breshtë, por jo pa vlera. Shqiptarët e kishin zakon ta merrnin në procesion nëpër fusha, çdo të diel të parë të majit, duke kënduar lutjet e tyre në gjuhën mëmë. Deri në fillim të shekullit XX ajo nderohej si mrekullibërëse dhe në epokën e festës, e celebruar deri gjysmën e dytë të shekullit XIX, mbledhte shumë e shumë njerëz.

Pak nga pak bijtë harruan vendlind-

SHQIPTARËT NË SHTETIN PAPNOR



SHTETI PAPNOR

Në kohën kur grupi i parë i shqiptarëve vendoset në territoret e Shtetit Papnor, Italia ishte e ndarë në rreth njëzet mbretëri, republika, dukate, veskovate, e principata. Kufijtë e shtetit papnor shtriheshin kryesisht në Lazio dhe Umbria, në atë zgjerim e tkurrje shekullore që kishin pësuar territoret.

Fillimi i shtetit të papëveve (quajtur ndryshe edhe Shteti Kishtar, Stato Ecclesiastico, apo Shteti i Kishës, Stato della Chiesa) e ka nismën në Donacionin e Konstandinit që i dha mundësinë Papës së Parë, Silvestro I, të përcillte pronësinë e dhuratave që i bëheshin, Një ndër të parat që një dhuratë e vetë Konstandinit, Pallati Lateran në Romë. Në shekuj donacionet vijuan për ta shndërruar që në shekullin VII papatin në pronarin më të mëdhenj të tokave e pronave në Itali.

Shteti Papnor përfundoi së ekzistuari më 20 shtator 1870, me marrjen e Romës nga Viktor Emanueli II i Savoiaje. Krisja mes Kishës dhe shtetit italian zgjati deri më 1929 kur me nënshkrimin e Akteve Lateranensë u krijuan Selia e Shenjtë dhe Qyteti i Vatikanit.

jen, akoma më shumë nipërit. Në vitet Dhjetë të shekullit XX, pasardhësit e fundit të kolonisë ishin të shpërndarë në fshatra të ndryshëm të provincës së Viterbos. Traditat e tyre nuk dallonin më nga ato të vendasve: dhe disa prej tyre harruan edhe origjinën e tyre ballkanike.

Por deri disa vjet para luftës së parë botërore, në rrugën kryesore të lagjes - Via degli Albanesi - mund të dëgjohej, veçanërisht gjatë orëve të mbrëmjes,

zëri i mprehtë i një zonje të moshuar të familjes Mida që merrte një këngë që pak a shumë thonte:

"Përse bir ke frikë nga nata? Yjet shihen në qiell,/por shikimi dhe dridhja e i tyre nuk kanë shkak frikën apo dhimbjen. Skënderbeu luftëtari hero. Nuk do ta shohim më kurrë atë që armët i kishte të arta dhe zemrën të çeliktë, oh ai nuk dridhej! Dhe natën, mbi kalin e zjarrit, fitonte mbi të gjithë armiqtë dhe liqenin që egërsohej tek e shihte e kapërcente në fluturim. Dridheshin yjet, bir; por shikimi dhe dridhja e i tyre nuk kishin shkak frikën apo dhimbjen. Skënderbeu, heroi, i gjallëronte me dritë yjet; dhe ato me t'u prekur prej asaj drite, si prej puthjes së parë të agimit, zbeheshin nga lumturia".

Plaka e vogël e familjes Mida që këndonte akoma në gjuhën e kadencën e të parëve të saj, një nga këngët antike të atdheut, ndodhet në varreza, larg liqenit të Shkodrës dhe vendeve ku heroi i paharrueshëm të cilit i këndonte, kishte kryer bëmat e tij. Në duart e familjes Mida - që si pasardhës të Remanit, patën pronat më të mëdha - mbetën edhe dokumentet e aktet notariale. Por asnjë prej tyre nuk u kthye më në Shqipëri.

Giovanni Armillotta

vijon nga faqja e parë

"Heroi i dy botëve" i mikluar me kaq dashuri në mesazhin që nuk mori kurrë (tekstualisht: "Amerika mund të krenohet me një Uashington, Svicra me një Vilhelm Tel, por Italia, akoma më krenare...") e dinte mirë, ama, sa i madh ishte shpirti patriotik i njerëzve të Lungros, fshat kalabrez në provincën e Kozencës. Pasi pikërisht nga ai vend, që falë Eparkisë konsiderohet "kryeqyteti fetar" i arbëreshëve, shqiptarëve të Italisë, i erdhi kontributi më i konsiderueshëm në përqindje marshimit garibaldian në Napoli. 500 vullnetarë nga 5 mijë banorë. Pa llogaritur pleqtë, fëmijët dhe gratë, praktikisht një çdo tre burra.

Episodi është kujtuar, rrëshqanthi, në një libërth me vlerë. Titullohet "Il Tenente Generale", shkruar nga Xhuzepe Martino Libri nuk ka shumë pretendime letrare e megjithatë duhet të lexohet në të gjitha shkollat. Si ilaç kundër helmeve të racizmit anti-shqiptar që, sipas sondazheve, infektajnë të rinjtë tanë në këto kohë gomonesh shqiptare, skllavesh shqiptare, skafistësh shqiptarë.

Libri tregon historinë e Pier Domenik Damisit, i ri i Lungros i brumur me ide liberale dhe risorxhimentale në Kolegjin italo-grek "Sant'Adriano" të San Demetrio Koronës, djep i inteligjencës shqiptare në Kalabri, aq i hapur në botën e ideve sa të sulmohej në vitin 1799 nga fshatarët pseudosanfedistë dhe filoburbonistë të bindur që: "Në San Demetrio edhe vetë Krishti është

Italianë, më italianë se shumë italianë. Donin aq shumë Xhuzepe Garibaldin sa ta krahasonin me heroin e tyre (si në një poezi të Zef Serembe i cili e krahason Garibaldin me Skënderbeun) e t'i venin nga pas me mijëra në marshimin nga Marsala drejt Napolit. Një dedikim absolut, edhe pse proverbi antik thotë: "nëse kalabrezët përballë italianëve ndjehen gungaçë, shqiptarët nuk ndjehen me një por me dy gunga në kurriz"



NJË USHTRI ARBËRESHE PER GARIBALDIN

jakobin!". Më 1844, Pier Domeniku ishte 24 vjeç, kur në Kalabri vdisnin Atilio dhe Emilio Bandiera në ndjekje të ëndrrës së tyre risorxhimentale. Pikërisht në atë moment zgjodhi çështjen së cilës do t'i përkushtonte gjithë jetën e tij. Duke u përfshirë në trazirat irridentiste të vitit 1844 e më pas të vitit 1847 e së fundi në përlëshjen e vitit 1848. Pikënisje e një ekzistence plot aventura: tre vjet i fshehur maleve, vendimi për të shkuar në Piemonte, kapja në shtëpinë e Maries (një grua patriotike që me ardhjen e xhandarëve në shtëpi hapte plisetë e fundit të gjerë, të kuq shqiptar për të fshehur të kërkuarin mes këmbëve të saj të bëshme), dënimi me vdekje i dhënë nga Gjykata e lartë e Krimeve.

Besonte vërtet tek Italia, i riu Damis. E tregojnë letrat që u dërgoi vëllezërve dhe nënës nga burgu i Procidës ku e kishin mbyllur pasi i kishin kthyer dënimin me vdekje në 25 vjet burg të egër. Letra të mrekullueshme të oficerit të ardhshëm të Ushtrisë mbretërore dhe të senatorit të ardhshëm, ku, me shprehje të paimagjinueshme, dilte në pah dashuria absolute për këtë atdhe të dytë në emër të të cilit ai dhe mijëra shqiptarë

të tjerë (edhe spe në shtëpi flitnin "arbëresh") ishin gati të jepnin edhe jetën. Më pas burgimi me Poerion dhe Setembrinin, imbakimi në një anije me vela për në mërgim, që sipas Burboneëve duhet të çonte sa më larg në Amerikë 66 patriotë, devijimi i drejtimit të anijes falë të birit të Setembrinit, sbarkimi në Angli e prej aty udhëtimi për në Torino e më pas në Kuarto për të marrë pjesë në mësymjen legjendare të Njëmijëve. Gjithnjë në krah të Garibaldit deri në betejën e Voltornos.

Në sfond gjithmonë ata: shqiptarët e Italisë. Dhjetëra mijëra burra e gra të përqëndruar thuajse në gjithë krahinat e jugut, nga Puljet deri në Sicili, veçanërisht në 25 komuna kalabreze, të ardhur valë-valë në vendin tonë (dhe të tyrin) shumë kohë më parë shpikjes së gomoneve. Duke filluar që nga viti 1461 (kur, me në krye Gjergj Kastriot Skënderbeun, erdhëm me mijëra në ndihmë të Ferdinandit të Aragonës) e më pas nga viti 1468 pas vdekjes së prijësit dhe fundit të ëndrrës së tij për t'u ndaluar turqve pushtimin e Shqipërisë.

Italianë, më italianë se shumë italianë. Donin aq shumë Xhuzepe Garibaldin sa ta krahasonin me heroin e tyre (si në

një poezi të Zef Serembe i cili e krahason Garibaldin me Skënderbeun) e t'i venin nga pas me mijëra në marshimin nga Marsala drejt Napolit. Një dedikim absolut, edhe pse proverbi antik thotë: "nëse kalabrezët përballë italianëve ndjehen gungaçë, shqiptarët nuk ndjehen me një por me dy gunga në kurriz". Një pasion i madh i dëshmuar jo vetëm nga origjina e Françesko Krispit, shqiptar i Sicilisë, por edhe nga historia e shumë protagonistëve të tjerë të Risorxhimentos. Si Axhesilao Milano, djali të cilin vranë në vitin 1856, pasi i nguli Ferdinandit të Dytë një bajonetë që shënoi përgjithnjë shëndetin e mbretit të Napolit. Apo Jeronim De Rada që, edhe pse i lindur e rritur në Kalabri edhe pse ka luftuar për Bashkimin e Italisë, konsiderohet më i madhi ndër poetët shqiptarë. Apo Rafaele Kamodeca, djalë nga familje e mirë, që u bashkua me vëllezërit Bandiera, e që kujtohet në një volum të moçëm të Serafin Gropës si "një hero i ri, që në moshën 24-vjeçare, kur më shumë se kurrë i buzëqeshte jeta, ra viktimë e plumbit të mallkuar. Dyi duke thirrur: 'Ky është çasti më i bukur i jetës time. Rroftë Italia!'".